

Rekomandimi CM/Rec(2024)2 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Kundërshtimin e Përdorimit të Padive Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP)

(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 5 prill 2024 në takimin e 1494-të të Zëvendësministrave)

Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të Nenet 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës (ETS Nr. 1),

Duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës është që të arrijë një unitet më të madh në mes të anëtarëve të tij, me qëllim që të mbrojë dhe promovojë idealet dhe parimet të cilat janë trashëgimia e tyre e përbashkët, *ndër të tjera* duke promovuar politika dhe standarde të përbashkëta;

Duke kujtuar angazhimin e Shteteve Anëtare për të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informimit, të garantuar nga Neni 10 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (ETS Nr. 5, më poshtë referuar si "Konventa") dhe siç interpretohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ("Gjykata") në praktikën e saj gjyqësore;

Duke kujtuar gjithashtu rëndësinë e barabartë të të drejtave të tjera të garantuara nga Konventa, përfshirë të drejtën për një gjykim të drejtë (Neni 6), të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare (Neni 8), të drejtën për lirinë e tubimit dhe organizimit (Neni 11) dhe të drejtën për zgjidhje efektive (Neni 13);

Duke kujtuar dhe riafirmuar se Shtetet Anëtare, përveç detyrimit të tyre negativ për t'u përmbajtur nga ndërhyrja në të drejtën e lirisë së shprehjes, kanë gjithashtu një detyrim pozitiv për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të favorshëm për pjesëmarrjen në debatin publik nga të gjithë, pa frikë, edhe kur opinionet e tyre bien ndesh me ato të mbrojtura nga autoritetet zyrtare ose pjesë të rëndësishme të publikut;

Duke përsëritur se zgjedhjet e lira dhe liria e shprehjes, veçanërisht liria e debatit politik, së bashku formojnë themelin e çdo sistemi demokratik dhe se, rrjedhimisht, ka pak hapësirë për kufizime në shprehjen politike ose debate për çështje me interes publik;

Duke theksuar se interesi publik duhet kuptuar gjerësisht pasi mbulon të gjitha çështjet që prekin dhe shqetësojnë publikun, përfshirë çështjet e diskutueshme, dhe se publiku ka të drejtë të informohet për çështje me interes publik, dhe gazetarët dhe mediat kanë për detyrë të japin informacion dhe ide për çështje të tilla;

Duke nënvizuar se përfshirja e zërave dhe perspektivave të ndryshme, përfshirë pakicat dhe opinionet e tjera jashtë rrjedhës kryesore, është thelbësore për sigurimin e debatit publik pluralist dhe një qytetarie të mirëinformuar dhe aktive;

Duke qenë të vetëdijshëm se asimetritë në format politike, financiare dhe forma të tjera të pushtetit në shoqëri mund të shkaktojnë pabarazi në debatin publik dhe se keqpërdorimi dhe shpërdorimi i pushtetit dhe privilegjeve duke kërcënuar ose ndërmarrë veprime ligjore për të ngacmuar, frikësuar ose heshtur zërat e pakicave ose ata kritik kanë një efekt frikësues në pjesëmarrjen e publikut;



Duke qenë thellësisht të shqetësuar për këmbënguljen në të gjithë Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës të një game të gjerë frikësimi, kërcënimi, dhune, vrasjesh dhe krimesh të tjera kundër individëve ose organizatave që veprojnë si vëzhgues publik, dhe me efektin frikësues që këto kërcënime kanë në pjesëmarrjen e publikut, veçanërisht kur ato mbeten të pandëshkuara;

Të alarmuar nga efekti frikësues për lirinë e shprehjes, debatin publik dhe pjesëmarrjen publike të shkaktuar nga veprimet ligjore që kërcënohen, iniciohen ose ndiqen si një mjet për të ngacmuar ose frikësuar objektivin e tyre dhe që synojnë të parandalojnë, pengojnë, kufizojnë ose penalizojnë shprehjen e lirë për çështjet me interes publik dhe ushtrimin e të drejtave që lidhen me pjesëmarrjen publike, të cilat shpesh quhen Padi Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike ("SLAPP");

Duke qenë të vetëdijshëm se SLAPP-et janë shpesh veprime të së drejtës civile, por që ato shfaqen edhe në kontekstin e së drejtës administrative dhe penale, dhe se kur procedura të tilla parashikojnë masa administrative dhe sanksione penale, ato mund të jenë veçanërisht kufizuese dhe më lehtë të përdorura kundër vëzhguesve publikë, duke rezultuar në një ndikim më të rëndë në individ dhe një efekt frikësues më të madh;

Duke vëzhguar me shqetësim se gratë dhe personat me orientime të ndryshme seksuale, identitet gjinor dhe shprehje dhe karakteristika seksuale, përballen me rreziqe specifike në cilësinë e tyre si gazetarë, mbrojtëse të të drejtave të njeriut dhe vëzhgues të tjerë publikë, përfshirë kur janë në shënjestër nga SLAPP, dhe duke vënë në dukje nevojën për të adresuar ndikimin e diferencuar të rreziqeve dhe sfidave që këta të fundit i hasin;

Duke u përpjekur për të konsoliduar dhe ndërtuar mbi përgjigjet ligjore dhe politike të marra tashmë nga Këshilli i Evropës, në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe rekomandimet dhe deklaratat e Komitetit të Ministrave, si Rekomandimi CM/Rec(2014)7 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve CM/Rec(2016)4 për Mbrojtjen e Gazetarisë dhe Sigurinë e Gazetarëve dhe Akterëve të tjerë të Medias, Rekomandimi CM/Rec(2022)4 për Promovimin e një Mjedisi të Favorshëm për Gazetari Cilësorë në Epokën Digjitale, dhe Deklarata e Komitetit të Ministrave mbi Dëshirueshmërinë e Standardeve Ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Forum Shopping në lidhje me Shpifjen, "Turizmi Shpifës", për të garantuar lirinë e shprehjes (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 4 korrik 2012 në mbledhjen e 1147-të të Zëvendësministrave), dhe duke njohur njëkohësisht rëndësinë e arritjes së konsistencës dhe koherencës ndërmjet instrumenteve dhe nismave të ndryshme në nivel evropian dhe ndërkombëtar;

Duke njohur urgjencën e hartimit të strategjive gjithëpërfshirëse dhe efektive për t'iu kundërvënë SLAPP-ve që forcojnë më tej kornizat dhe praktikat ekzistuese legjislative dhe politike,

Rekomandon që qeveritë e Shteteve Anëtare:

- i. të zbatojnë, urgjentisht dhe nëpërmjet të gjitha degëve të autoriteteve shtetërore brenda kompetencës së tyre, udhëzimet e përcaktuara në shtojcën e këtij rekomandimi, duke marrë parasysh plotësisht parimet e përfshira në të, veçanërisht në lidhje me masat mbrojtëse strukturore dhe procedurale, mjetet juridike, transparencën, mbështetjen për të shënjestruarit dhe viktimat, edukimin, trajnimin, rritjen e ndërgjegjësimit si dhe ndërtimin e kapaciteteve;
- ii. t' i kushtojnë vëmendje të veçantë SLAPP-ve në kontekstin e rishikimeve të ligjeve, politikave dhe praktikave vendase përkatëse të tyre, përfshirë përputhjen me Rekomandimin CM/Rec(2016)4 për Mbrojtjen e Gazetarisë dhe Sigurinë e Gazetarëve dhe Akterëve të tjerë të Medias, për të siguruar përputhje të plotë me detyrimet e Shteteve Anëtare sipas Konventës;
- iii. të promovojnë qëllimet e këtij rekomandimi në nivel kombëtar, si dhe në forumet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare, dhe të angazhohen dhe të bashkëpunojnë me të gjitha palët e interesuara për arritjen e këtyre synimeve;
- iv. të rishikojnë rregullisht statusin e zbatimit të këtij rekomandimi me synimin për të rritur ndikimin e tij, në veçanti përmirësimin e mekanizmave mbështetës për të shënjestruarit dhe viktimat, dhe të informojnë Komitetin e Ministrave për masat e marra nga Shtetet Anëtare dhe palët e tjera të interesit, progresin e arritur dhe çdo mangësi të mbetur.

Shtojca e Rekomandimit **CM/Rec(2024)2** të Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Kundërshtimin e Përdorimit të Padive Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP)

I. Fushëveprimi dhe përkufizimet

1. Për qëllimet e këtij rekomandimi, Paditë Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike ("SLAPP") kuptohen si veprime ligjore që kërcënohen, iniciohen ose ndiqen si një mjet për të ngacmuar ose frikësuar objektivin e tyre dhe që synojnë të parandalojnë, pengojnë, kufizojnë ose penalizojnë shprehjen e lirë për çështjet me interes publik dhe ushtrimin e të drejtave që lidhen me pjesëmarrjen publike.

2. Qëllimi qendror i këtij rekomandimi, mbrojtja e pjesëmarrjes publike kundër SLAPP-ve dhe parandalimi i përdorimit të mëtejshëm i SLAPP-ve në Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës, është që të realizohet si pjesë e përbushjes nga Shtetet Anëtare të detyrimeve të tyre më të gjera sipas Konventës për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të favorshëm për pjesëmarrje në debatin publik, i cili është një tipar thelbësor i shoqërive demokratike pluraliste që respektojnë plotësisht sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut. Përbushja e këtyre detyrimeve udhëhiqet nga ndërgjegjësimi se një sërë llojesh të ndryshme kërcënimesh kanë një efekt frikësues për pjesëmarrjen në debatin publik dhe çojnë në autocensurë, duke i privuar shoqëritë nga oferta pluraliste e informacionit dhe ideve që u nevojiten individëve për të marrë vendime të informuara. Ndërkohë që nevojitet veprim kundër SLAPP-ve, duhet të arrihet gjithashtu një ekuilibër i kujdesshëm ndërmjet palëve të interesuara në mënyrë që të mos pengohet e drejta e qasjes në gjykatë.

3. SLAPP-ët mund të marrin forma të ndryshme dhe u nënshtrohen dispozitave të ndryshme në kornizat legjislative kombëtare. Një nga sfidat për Shtetet Anëtare në përpjekjet e tyre për të parandaluar SLAPP-ët dhe për t'iu kundërvënë efekteve të dëmshme të tyre është të jenë në gjendje të identifikojnë SLAPP-ët në mënyrë të shpejtë dhe të sigurojnë që masat legjislative dhe të tjera mbrojtëse janë në fuqi për të gjitha paditë e tilla. Prandaj, ky rekomandim sqaron termat kyç dhe jep udhëzime mbi kriteret përcaktuese të SLAPP-ve në mënyrë që të ndihmojë Shtetet Anëtare të identifikojnë SLAPP-ët dhe të përshtatin masat mbrojtëse ligjore të përshtatshme dhe efektive, përgjigjet dhe masat e tjera për të kundërshtuar efektet e tyre të dëmshme. Ai gjithashtu përcakton tregues të ndryshëm.

Termtat kyç

4. Për qëllimet e këtij rekomandimi dhe në përputhje me të drejtat e parashikuara në Konventë, siç interpretohen nga Gjykata në praktikën e saj gjyqësore, termtat kyç të mëposhtëm kuptohen në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe tërësore:

a. "Pjesëmarrja publike" i referohet të drejtës demokratike të secilit për të marrë pjesë në debatin publik dhe çështjet publike, *online dhe offline*, pa frikë apo diskriminim. Kjo përfshin të drejtën për të shprehur mendime dhe ide që bien ndesh ose janë kritike ndaj atyre që mbrohen nga autoritetet zyrtare ose nga një pjesë e konsiderueshme e opinionit publik, ose që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë shtetin ose çdo sektor të popullsisë, siç sqarohet nga Gjykata. Nacioni "të gjithë" përfshin të gjithë vëzhguesit publikë dhe kontribuesit në debatin publik dhe të gjithë pjesëmarrësit në çështjet publike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: gazetarët, organizatat e medias, profesionistët e medias dhe akterët e tjerë të medias, si gazetarët qytetarë; organizatat e shoqërisë civile, për shembull shoqatat dhe aktivistët mjedisorë dhe kundër korrupsionit; sindikatat; sinjalizuesit; akademikët; blogerët; mbrojtësit e të drejtave të njeriut; profesionistët juridikë; përdoruesit e mediave sociale; akterët kulturorë dhe akterët e industrisë krijuese.

"Pjesëmarrja publike" i referohet gjithashtu të drejtës për lirinë e tubimit dhe organizimit dhe të drejtës për të votuar dhe për të dalë në zgjedhje. Kështu, pjesëmarrja e publikut mund të përfshijë një shumëllojshmëri të gjerë aktiviteteve si avokatia, gazetaria, hetimi dhe raportimi i shkeljeve të ligjit ose normave etike, kërkimi akademik, mësimdhënia, debati, shkrimi për zyrtarët e qeverisë ose klientët e korporatave, qarkullimi i peticioneve, të qenit palë në proceset gjyqësore të dizajnuara për të avancuar ndryshimet shoqërore ose për të mbrojtur të drejtat ekzistuese ose mjedisin, duke u angazhuar në protesta ose bojkotime paqësore, duke u angazhuar me mekanizma rajonalë ose ndërkombëtarë, ose thjesht duke folur kundër keqpërdorimit ose abuzimit të pushtetit, abuzimeve të të drejtave të njeriut, korrupsionit, mashtrimit ose komentimit të ndonjë çështjeje me interes publik. Fushëveprimi i termit mbulon gjithashtu veprimet që përgatitin, mbështesin ose ndihmojnë pjesëmarrjen publike.

b. "Interesi publik" i referohet të gjitha çështjeve që prekin publikun dhe në të cilat publiku mund të ketë interes legjitim, veçanërisht ato çështje që kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme sociale ose që ndikojnë në mirëqenien e individëve ose jetën e komunitetit ose mjedisit. Publiku ka të drejtë të marrë informacione dhe ide dhe në këtë mënyrë të informohet për çështje me interes publik, dhe gazetarët dhe mediat kanë për detyrë të japin informacion dhe ide të tilla. Interesi publik shtrihet në çështje që mund të shkaktojnë polemika të konsiderueshme, por ai nuk mund të reduktohet në etjen e publikut për informacion në lidhje me jetën private të të tjerëve, ose në dëshirën e audiencës për sensacionizëm ose vojerizëm. Politika, çështjet aktuale, të drejtat e njeriut, drejtësia, mirëqenia sociale, arsimiti, barazia gjinore, orientimi seksual dhe identiteti gjinor, ngacmimi ose dhuna seksuale ose me bazë gjinore, çështjet shëndetësore, feja, kultura, historia, korrupsioni, klima dhe çështjet mjedisore janë kështu të gjithë shembujt e temave me interes publik, ndryshe nga marrëdhëniet private të individëve apo çështjet familjare. Temat mund të jenë me interes publik në nivel lokal, kombëtar ose ndërkombëtar.

Kriteret përcaktuese të SLAPP-ve

5. **Synimi i pjesëmarrjes publike** – Veprimi ligjor synon të keqpërdor ose abuzojë me procesin ligjor për të parandaluar, penguar, kufizuar ose penalizuar shprehjen e lirë për çështje me interes publik dhe ushtrimin e të drejtave që lidhen me pjesëmarrjen publike.

6. **Mbulimi i të gjitha shkaqeve të veprimit ligjor** – Veprimet ligjore mund të përfshijnë keqpërdorimin ose abuzimin e të gjitha llojeve të ligjit statutor ose të zakonshëm për të parandaluar, penguar, kufizuar ose penalizuar kontributet në debatin publik, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, shpifjen, fyerjen, cenimin e privatësisë, konspiracionin, shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale, ndërhyrjen ekonomike ose shkaktimin e dëmtimit emocional. Ndërsa kjo në përgjithësi do të nënkuptojë një padi civile, në disa juridiksione është e mundur të shkaktohen kundërvajtje, masa administrative ose kallëzime penale kundër kritikëve të tyre, duke përfshirë përdorimin e urdhrave. Ky përkufizim shtrihet edhe tek "taktikat ligjore të frikësimit" – masat e ndërmjetme ose të përkohshme, thirrjet agresive ose kërcënimet e thjeshta të krijuara për të frikësuar palën tjetër që të tërhiqet.

7. **Të gjitha fazat e veprimit juridik** – Të gjitha fazat e veprimit ligjor janë të rëndësishme, duke përfshirë një kërcënim fillestar të veprimit ligjor, i cili në vetvete mund të ketë një efekt frikësues në pjesëmarrjen publike, si dhe në procedurat përmbarimore.

Treguesit e SLAPP-ve

8. SLAPP-ët manifestohen në mënyra të ndryshme dhe tregues të ndryshëm mund të përdoren për t'i identifikuar ato. Tregues të tillë përfshijnë, por nuk kufizohen në, elementet e mëposhtme:

- a. paditësi përpiqet të shfrytëzojë një çekuilibër të pushtetit, siç është avantazhi i tij financiar ose ndikimi politik ose shoqëror, për të ushtruar presion mbi të pandehurin;
- b. argumentet e paraqitura nga paditësi janë pjesërisht ose plotësisht të pabazuara;
- c. mjetet juridike të kërkuara nga paditësi janë joproporcionale, të tepërta ose të paarsyeshme;
- d. pretendimet përbëjnë abuzim të ligjeve ose procedurave;
- e. paditësi angazhohet në taktika procedurale dhe gjyqësore të dizajnuara për të rritur shpenzimet për të pandehurin, të tilla si vonesa e procedurave, zgjedhja e një forumi që është i pafavorshëm për pjesëmarrjen e publikut ose i bezdisshëm për të pandehurin, provokimi i një ngarkese të rëndë pune dhe ndjekja e apeleve me pak ose aspak perspektivë suksesi;
- f. veprimi ligjor synon qëllimisht individët dhe jo organizatat përgjegjëse për veprimin e kundërshtuar;
- g. veprimi ligjor shoqërohet nga një ofensivë e marrëdhënive me publikun e krijuar për të ngacmuar, diskredituar ose frikësuar akterët që marrin pjesë në debatin publik ose që synon të largojë vëmendjen nga çështja thelbësore në fjalë;
- h. paraqitësi i kërkesës ose përfaqësuesit e tyre përfshihen në frikësim ligjor, ngacmim ose kërcënim, ose kanë një histori të tillë;
- i. paditësi ose palët e lidhura angazhohen në veprime juridike të shumëfishta dhe të koordinuara ose ndërkufitare në bazë të të njëjtit grup faktesh ose në lidhje me çështje të ngjashme;
- j. paditësi refuzon sistematikisht të angazhohet me mekanizma jogjyqësorë për të zgjidhur padinë.

9. Ndërsa SLAPP-ët nuk përfshijnë domosdoshmërisht të gjithë këta tregues, sa më shumë prej tyre të jenë të pranishëm ose sa më akute të jetë sjellja, aq më shumë ka të ngjarë që veprimi juridik të konsiderohet si SLAPP.

Forma/lloje specifike të SLAPP-ve

10. Përveç karakteristikave të përgjithshme të SLAPP-ve, Shtetet Anëtare duhet të marrin parasysh karakteristikat dalluese të llojeve specifike të SLAPP-ve dhe pasojat e tyre ligjore dhe të marrin masat e duhura dhe efektive për të adresuar kërcënimet specifike të paraqitura.

i. SLAPP ndërkufitare

11. Krahasuar me SLAPP-ët vendase të ndjekura brenda një sistemi ligjor kombëtar, SLAPP-ët ndërkufitare ose SLAPP-ët të ndjekura në juridiksione të ndryshme, përfshijnë shtresa shtesë ndërlikueshmërie, kostosh dhe stresi. Mbrojtja me sukses e SLAPP-ve ndërkufitare kërkon njohuri eksperte të sistemeve të shumta ligjore kombëtare. Kjo zakonisht përfshin angazhimin e avokatëve që janë aktivë profesionalisht në ose që kanë ekspertizë në juridiksione përkatëse, duke rritur kështu kohën dhe kostot e përgjithshme të shpenzuara për përgatitjen dhe mbrojtjen e veprimeve ligjore dhe duke përkeqësuar efektin frikësues.

12. Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e duhura dhe efektive për të kufizuar *Forum Shopping* që janë të pafavorshme për pjesëmarrjen e publikut ose të dëmshme për të pandehurin, duke përfshirë siç përcaktohet në Deklaratën e Komitetit të Ministrave për Dëshirueshmërinë e Standardeve Ndërkombëtare që kanë të bëjnë me *Forum Shopping* në lidhje me Shpifjet, "Turizmi Shpifës", për të garantuar lirinë e shprehjes.

13. Shtetet Anëtare duhet gjithashtu të ofrojnë mbrojtje efektive kundër gjykimeve të vendeve të treta, duke pasur parasysh, sipas rastit, standardet evropiane dhe ndërkombëtare në zhvillim në këtë drejtim.

14. Shtetet Anëtare inkurajohen të vendosin rregulla për të siguruar që, kur SLAPP-ët janë paraqitur para autoriteteve gjyqësore ose të tjera të një vendi të tretë kundër një personi fizik ose juridik me vendbanim në një Shtet Anëtar, ai person mund të kërkojë, përpara autoriteteve gjyqësore ose të tjera të vendit ku ai ka vendbanimin, kompensimin e dëmeve dhe shpenzimeve të shkaktuara në lidhje me procedimet përpara organeve gjyqësore ose autoriteteve të tjera të vendit të tretë, pavarësisht nga vendbanimi i paditësit në procedurat në vendin e tretë.

ii. SLAPP-et e shumëfishta ose të koordinuara

15. Presioni dhe ngacmimi i shkaktuar nga keqpërdorimi ose shpërdorimi i ligjit dhe procesit ligjor shtohen dhe rëndohen dhe kostot ligjore rriten, kur një i pandehur ose një grup të pandehurish i nënshtrohet SLAPP-ve të shumëfishta ose të koordinuara.

16. Autoritetet gjyqësore ose autoritetet e tjera të Shteteve Anëtare, kur vlerësojnë nëse një pretendim ligjor përbën një SLAPP, ose kur shqyrton një rast SLAPP, duhet ta kenë parasysh dhe të marrin masat e duhura dhe efektive për të eliminuar ose të paktën reduktuar ndikimin rëndues të SLAPP-ve të shumëfishta ose të koordinuara kundër të pandehurve.

17. Shtetet Anëtare duhet gjithashtu të paraqesin rregulla për të parandaluar paditësin nga fillimi i procedurave shtesë në lidhje me të njëjtën çështje, si dhe rregulla për t'u mundësuar autoriteteve gjyqësore ose të tjera të menaxhojnë në mënyrë efektive procedurat e ko-ordinuara që janë të lidhura ngushtë, në mënyrë që të shmangët ekspozimi i të pandehurit ndaj procedurave të shumëfishta.

iii. SLAPP-et që synojnë pjesëmarrjen anonime të publikut

18. Një tipar dallues i SLAPP-ve që synojnë pjesëmarrjen anonime të publikut është se paditësi kërkon të detyrojë zbulimin e identitetit të të pandehurit, pjesëmarrja e të cilit është bërë në mënyrë anonime ose me pseudonim, shpesh për shkak të frikës për sigurinë e tyre nëse do të flisnin me emrat e tyre të vërtetë. Pasi të jetë zbuluar identiteti i pjesëmarrësve publikë, ata janë më të ndjeshëm ndaj kërcënimeve, frikësimit, abuzimit dhe sulmeve.

19. Shtetet Anëtare duhet të vendosin masa mbrojtëse të përshtatshme dhe efektive për të mbrojtur identitetin e pjesëmarrësve publikë anonimë dhe burimeve konfidenciale në mënyrë që të kufizojnë zbulimin e identitetit të tyre në masën e nevojshme për administrimin e duhur të drejtësisë, në përputhje me Konventën, përfshirë parimin e barazisë së armëve, Konventën e Modernizuar për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (CETS nr. 223), Rekomandimin CM/Rec(2014)7 e Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe standardeve të tjera përkatëse për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave.

II. Masat mbrojtëse, mjetet juridike dhe transparenca

20. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që sistemet e tyre ligjore kombëtare dhe zbatimimi i tyre të ofrojnë një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse dhe grup koherent të masave mbrojtëse strukturore dhe procedurale për të parandaluar dhe minimizuar efektet e dëmshme të SLAPP-ve, si dhe një grup të plotë mjetesh juridike dhe masash mbështetëse për dëmet e shkaktuara nga SLAPP-ët. Ato gjithashtu duhet të marrin masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar një kulturë transparence rreth pretendimeve ligjore që janë gjetur se përbëjnë SLAPP-et.

A. Korniza ligjore

21. Shtetet Anëtare duhet të vendosin një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative që i mundëson të gjithëve të marrin pjesë në debatin publik dhe çështjet publike në mënyrë efektive, të sigurt dhe pa frikë.

22. Shtetet Anëtare duhet të mbajnë ose të marrin, sipas rastit, masat e nevojshme legjislative ose të tjera për të parandaluar veprimet ligjore që kërcënohen, inicoohen ose ndiqen për të parandaluar, penguar, kufizuar ose penalizuar shprehjen e lirë të çdo personi juridik ose fizik për çështje me interes publik dhe ushtrimin e të drejtave që lidhen me pjesëmarrjen e publikut. Ato duhet gjithashtu të ushtrojnë vigjilencë për të siguruar që legjislacioni, sanksionet dhe mjetet juridike të mos zbatohen në mënyrë diskriminuese ose arbitrare kundër pjesëmarrjes së publikut.

23. Korniza legjislative duhet të mbahet nën rishikim të rregullt për të vlerësuar dhe siguruar pajtueshmërinë e kornizës dhe zbatimin e saj me Konventën. Rishikimet duhet të mbulojnë të gjithë legjislacionin ekzistues dhe projektligjin dhe legjislacionin dytësor, si dhe praktikën ligjore, që ka të bëjë me të drejtat për lirinë e shprehjes, tubimin paqësor dhe organizimin, dhe të drejtat e tjera pjesëmarrëse. Shtetet Anëtare duhet, aty ku është e nevojshme, të marrin çdo masë legjislative dhe masa të tjera të përshtatshme për të mbrojtur këto të drejta.

B. Masat mbrojtëse procedurale

Menaxhimi efektiv i rasteve

24. Shtetet Anëtare duhet të fuqizojnë autoritetet gjyqësore dhe autoritetet e tjera kompetente për të menaxhuar në mënyrë aktive dhe efektive procedurat në mënyrë që të mundësojnë përfundimin efektiv të rastit dhe për të shmangur çdo taktikë vonuese. Për të arritur një menaxhim efektiv të rastit, autoritetet gjyqësore dhe autoritetet e tjera kompetente duhet të sigurojnë që palët të paraqesin pretendimet, mbrojtjen, pretendimet faktike dhe ofertat mbi provat sa më herët dhe plotësisht të jetë e mundur dhe sa më të përshtatshme për zhvillimin e kujdesshëm të procesit gjyqësor, në mënyrë që të sigurohet përshtatshmëria procedurale.

Hedhja poshtë paraprake e pretendimeve kundër pjesëmarrjes së publikut

25. Shtetet Anëtare duhet të hartojnë dispozita adekuate dhe të përshtatshme në kornizën e tyre ligjore kombëtare në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe parimet e praktikës gjyqësore të Gjykatës për të mundësuar që:

- a. gjykatat, me iniciativën e tyre, të hedhin poshtë një pretendim si SLAPP në fillim të procedurës; dhe,
- b. të paditurit të paraqesin kërkesa për hedhjen poshtë paraprake të pretendimeve kundër pjesëmarrjes së publikut, në mënyrë që të kundërshtohen efektet e dëmshme të SLAPP-ve në debatin e çështjeve të interesit publik.

Dispozita të tilla duhet t'u kërkojnë pretenduesve që synojnë pjesëmarrjen e publikut të përcaktojnë një shkak të arsyeshëm veprimi në fazën më të hershme të mundshme në proces, në mënyrë që të kalojnë në gjyq.²⁶ Autoritetet gjyqësore dhe autoritetet e tjera kompetente duhet të kenë kompetencat ligjore për të bërë një vlerësim të treguesve në paragrafin 8 (sipër) dhe të ndërpresin plotësisht ose pjesërisht pretendimin.

27. Kushtet për pranueshmërinë e kërkesave për hedhjen poshtë paraprake duhet të përcaktohen nga ligji kombëtar dhe mund të përfshijnë, për shembull, shqyrtimin gjyqësor të kriterëve kumulative të mëposhtme:

- a. nëse kërkesa nuk ka gjasa të ketë sukses në gjykim; dhe
- b. nëse procedimi përbën abuzim të procesit, në dritën e treguesve SLAPP të përcaktuar në paragrafin 8 (më lart).

28. Kur kufizimet kohore për ushtrimin e së drejtës për të paraqitur kërkesë për hedhjen poshtë paraprake janë të përcaktuara me ligj, ato duhet të jenë proporcionale dhe të mos e bëjnë të pamundur ose tepër të vështirë ushtrimin e kësaj të drejte.

29. Kërkesat për hedhjen poshtë paraprake të SLAPP-ve duhet të përfshijnë të drejtën e të dyja palëve për t'u dëgjuar bazuar në parimin e kundërshtarit dhe duhet të trajtohen me përshtatshmërinë e duhur nga autoritetet gjyqësore dhe autoritetet e tjera kompetente, duke marrë parasysh rrethanat e rastit, të drejtën për një mjet efektiv juridik, të drejtën për një gjykim të drejtë, dhe zbatimin e treguesve SLAPP të përcaktuar në paragrafin 8 (më lart).

30. Shtetet Anëtare duhet të mundësojnë në mënyrë të barabartë organet administrative të hedhin poshtë pretendimet administrative kundër pjesëmarrjes së publikut në fillim të procesit.

31. Kur i pandehuri paraqet një kërkesë për hedhjen poshtë të pretendimeve kundër pjesëmarrjes së publikut, duke sjellë prova që pretendimi rrjedh nga pjesëmarrja e publikut për një çështje me interes publik dhe janë të pranishëm një sërë treguesish të SLAPP-ve, dhe kur organet gjyqësore dhe autoritetet e tjera kompetente e pranojnë kërkesën, duhet t'i takojë paditësit të sigurojë prova kundër hedhjes poshtë. Kjo nuk i pengon Shtetet Anëtare të paraqesin rregulla provash që janë më të favorshme për të pandehurit.

32. Paditësit duhet t'i jepet e njëjta mundësi për të provuar se veprimi juridik ka të ngjarë të ketë sukses në gjykim ose në një procedurë administrative dhe nuk synon të parandalojë, kufizojë ose penalizojë ushtrimin e të drejtave që lidhen me pjesëmarrjen e publikut.

33. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që vendimi për hedhjen poshtë paraprake të jetë i apelueshëm.

34. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që një kërkesë për hedhjen poshtë paraprake ose çdo apelim prej saj të trajtohet në një procedurë të përsheptuar, duke marrë parasysh rrethanat e rastit, të drejtën për një mjet juridik efektiv dhe të drejtën për një gjykim të drejtë.

Pushimi i procedurës

35. Kur legjislacioni kombëtar e lejon, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që, nëse i pandehuri aplikon për hedhjen poshtë paraprake, procedurat kryesore të pezullohen derisa të merret një vendim përfundimtar për atë kërkesë. Për më tepër, rregullat për pezullimin e procedurës nuk duhet të lejojnë paditësin të ndryshojë pretendimet në procedurë me qëllim të shmangies së urdhrit të hedhjes poshtë. Çdo ndryshim i deklaratave duhet t'i nënshtrohet miratimit të autoritetit gjyqësor ose autoritetit tjetër kompetent. Ndryshimi i pretendimeve nuk duhet të lejohet pasi i pandehuri të depozitojë kërkesën për hedhjen poshtë paraprake.

36. Refuzimi i një kërkesë për hedhjen poshtë paraprake të procedurës nuk duhet të ketë efekt që të pengojë të pandehurin që të argumentojë përsëri, përpara gjykatësit që të vendosë në themel, se procedimi ndaj tij përbën një SLAPP.

Sigurimi për shpenzimet procedurale dhe dëmet

37. Shtetet Anëtare duhet të vendosin rregulla, në përputhje me ligjin dhe praktikën kombëtare, për të siguruar që në proceset gjyqësore kundër pjesëmarrjes së publikut, autoritetet gjyqësore dhe autoritetet e tjera kompetente kanë fuqinë t'i kërkojnë paditësit të sigurojë siguri për shpenzimet procedurale, ose për shpenzimet dhe dëmet procedurale, nëse e konsideron këtë siguri të përshtatshme në funksion të pranisë së treguesve të SLAPP-ve, siç përcaktohet në paragrafin 8 (më sipër).

Kthimi i shpenzimeve ligjore

38. Shtetet Anëtare inkurajohen të hartojnë dispozitat e duhura në sistemet e tyre ligjore kombëtare për t'u mundësuar gjykatave, me përcaktimin se një kërkesë ligjore përbën një SLAPP, të urdhërojnë paditësit të përballojnë të gjitha shpenzimet e procedurës, duke përfshirë kostot e plota të përfaqësimit ligjor të shkaktuara nga i pandehuri.

Vdekja ose humbja e aftësisë juridike të të pandehurit

39. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që kur, me vdekjen ose humbjen e aftësisë juridike të të pandehurit, në një rast në pritje kundër pjesëmarrjes së publikut, anëtarët e familjes dhe bashkëpunëtorët e të pandehurit fillestar që vazhdojnë procedurat gjyqësore të kenë qasje në të njëjtat mjete juridike dhe mbështetje si i pandehuri fillestar. Shtetet Anëtare inkurajohen të ofrojnë mbrojtje të mëtejshme, sipas nevojës, pasi këta të pandehur të rinj mund të jenë më pak të përgatitur për t'u përballur me pretendimin fillestar.

C. Mjetet juridike

Shpenzimet ligjore dhe të tjera procedurale

40. Shtetet Anëtare duhet të hartojnë dispozita të përshtatshme legjislative ose dispozita të tjera për të siguruar që kostot për pretendimet e SLAPP-ve të mbahen në një minimum absolut.

Njohja e statusit të viktimës të SLAPP-ve dhe kompensimi i dëmeve

41. Shtetet Anëtare duhet të hartojnë masa adekuate që viktimat e SLAPP-ve të njihen si të tilla dhe të kompensohen plotësisht për dëmet e shkaktuara si rezultat i SLAPP-ve, duke mbuluar dëmet materiale dhe jomateriale, të tilla si humbja e të ardhurave dhe shqetësimi emocional, si dhe kompensimi për kostot dhe shpenzimet, për shembull për të mbuluar shpenzimet ligjore dhe administrative,

Kufiri i dëmeve për paditësin

42. Shtetet Anëtare duhet që, brenda mundësive të sistemeve të tyre ligjore kombëtare, të parashikojnë kufizimin e dëmeve, me qëllim parandalimin e gjobave financiare abuzive ose joproporcionale për të pandehurit, të cilat do të kishin një efekt frikësues në pjesëmarrjen e tyre publike dhe të shmangin krijimin e stimujve financiarë për paraqitjen e veprimeve ligjore.

Kufiri i kostove

43. Shtetet Anëtare duhet, brenda mundësive të sistemeve të tyre ligjore kombëtare, të parashikojnë kufizimin e kostove, për të siguruar që të pandehurit të kenë mundësinë të mbrohen në mënyrë efektive dhe të mbrohen nga procedurat gjyqësore që zgjaten me qëllim që të shterojnë burimet financiare të të pandehurve, gjë që do të kishte një efekt frikësues mbi pjesëmarrjen e tyre publike.

Masat frenuese

44. Shtetet Anëtare duhet të vendosin një sistem ndëshkimesh efektive, proporcionale dhe bindëse për të penguar SLAPP-ët. Kjo duhet të jetë në përpjesëtim me burimet në dispozicion të paraqitësit të kërkesës në mënyrë që të sigurojë një pengesë efektive për pretenduesit e mundshëm të ardhshëm të SLAPP-ve. Shtetet Anëtare duhet të konsiderojnë sigurimin e dëmeve dhe gjobave për rastet kur paditësi ka shfaqur sjellje veçanërisht skandaloze, dhe kur koha e humbur dhe dëmi psikologjik i shkaktuar ndaj të pandehurit duhet të kompensohen. Shtetet Anëtare duhet gjithashtu të marrin në konsideratë, si parandalim të mëtejshëm, mundësinë e vendosjes së dënimeve të rënduara për pretenduesit që paraqesin në mënyrë të përsëritur SLAPP-ët.

45. Shtetet Anëtare duhet të hartojnë dispozitat e duhura legjislative për të siguruar që, në rast të një veprimi juridik që konsiderohet si një SLAPP, autoritetet gjyqësore ose të tjera mund të urdhërojnë, me kërkesë të të pandehurit dhe në kurriz të paditësit, masat e duhura për shpërndarjen e informacionit në lidhje me vendimin, duke përfshirë publikimin e plotë ose të pjesëshëm të tij dhe emrat e personave juridikë ose fizikë që kanë dorëzuar SLAPP-ët, në përputhje me standardet evropiane të të drejtave të njeriut dhe të mbrojtjes së të dhënave.

Lehtësimi i mjeteve juridike jogjyqësore

46. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë me mjetet e duhura kushtet për qasje efektive në mjete juridike jogjyqësore, siç janë zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve, ndërmjetësimi dhe këshillat e shtypit, duke respektuar plotësisht pavarësinë e të njëjtëve mekanizma, për zgjidhjen e rasteve të SLAPP-ve.

D. Kultura e transparencës

47. Shtetet Anëtare duhet të ndërmarrin masat e duhura për të siguruar transparencë dhe publicitet të plotë rreth rasteve që konstatohen nga autoritetet gjyqësore kombëtare dhe autoritetet e tjera se përbëjnë SLAPP, duke përfshirë mundësinë e publikimit të gjykatave.

48. Shtetet Anëtare duhet të mundësojnë mbledhjen e të dhënave në lidhje me rastet e SLAPP-ve. Për këtë qëllim, ato duhet të parashikojnë krijimin e një regjistri publik të rasteve që janë klasifikuar si SLAPP. Regjistrat duhet të mbahen të përditësuara dhe të vihen në dispozicion të publikut pa pagesë dhe pa vonesë. Me synimin për të garantuar qasje të plotë në të dhëna, Shtetet Anëtare duhet ta bëjnë regjistrin të qasshëm, në mënyrë ideale *offline dhe online*, në përputhje me standardet evropiane të të drejtave të njeriut dhe të mbrojtjes së të dhënave përkatëse.

49. Shtetet Anëtare duhet të marrin në konsideratë ndërmarrjen e masave të duhura për të siguruar që autoritetet gjyqësore ose autoritetet e tjera kompetente t'u ofrojnë informacion shoqatave të avokatëve rreth rezultatit të rasteve të SLAPP-ve.

III. Mbështetje për objektivat dhe viktimat e SLAPP-ve

50. Shtetet Anëtare inkurajohen të organizojnë, ofrojnë dhe sigurojnë qasje të shpejtë në një sërë masash mbështetëse dhe mbrojtëse për objektivat dhe viktimat e SLAPP-ve. Duhet të zbatohen gjithashtu procedura për të siguruar mbrojtjen e tyre fizike nga çdo dëm i mundshëm. Shtetet Anëtare duhet të lehtësojnë ofrimin e mbështetjes nga akterët përkatës për objektivat dhe viktimat e SLAPP-ve, të tilla si ato që ndajnë burimet e duhura për të ofruar një mbështetje të tillë. Në mënyrë që të jenë efektive në praktikë, Shtetet Anëtare duhet të konsiderojnë organizimin e mbështetjes në konsultim me viktimat dhe të shënjestruarit, duke përfshirë edhe shoqatat e tyre specifike, të përshtatin mbështetjen për nevojat dhe situatat e tyre specifike dhe të marrin plotësisht parasysh karakteristikat ose statusin e tyre personal. Kjo gamë masash duhet të vihet në dispozicion edhe për viktimat dytësore ose indirekte të SLAPP-ve, siç janë anëtarët e familjes, bashkëpunëtorët ose avokatët e të shënjestruarve dhe viktimave, të cilët duhet të mbrohen në mënyrë adekuate nga dëmet e shkaktuara nga SLAPP-ët.

51. *Mbështetje ligjore* – Aty ku është e nevojshme dhe sipas legjislacionit kombëtar, Shtetet Anëtare duhet të konsiderojnë ofrimin e qasjes adekuate në asistencë ligjore falas, përfshirë edhe në dritën e treguesve në paragrafin 8 (më sipër). Gjithashtu duhet të vihen në dispozicion mekanizmat dhe instrumentet ekzistuese kombëtare që organizojnë dhe ofrojnë mbështetje ligjore. Shtetet Anëtare duhet të inkurajojnë dhe fuqizojnë organizatat e pavarura të specializuara në mbështetjen ligjore, shoqatat e profesionistëve ligjorë, këshillat e medias dhe shtypit, organizatat e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, sindikatat dhe shoqatat e gazetarëve, institucionet akademike që ofrojnë shërbime ligjore dhe organizata të tjera joqeveritare për të ofruar shërbime ligjore për objektivat e SLAPP-ve. Shtetet Anëtare duhet, që në bashkëpunim me palët përkatëse të interesit, të përpiqen të sigurojnë që personat fizikë dhe juridikë që janë shënjestra të SLAPP-ve të jenë në gjendje të marrin qasje në sigurime për mbështetje ligjore në kushte të drejta.

52. *Mbështetje financiare* – Shtetet Anëtare duhet të konsiderojnë ofrimin e mbështetjes financiare për viktimat e SLAPP-ve, në bashkëpunim me shoqatat kombëtare të gazetarëve, sindikatat dhe organizatat përkatëse të shoqërisë civile, duke përfshirë krijimin e fondeve kombëtare, granteve dhe/ose asistencës tjetër të synuar, ose mbështetjen e fondeve ose projekteve ekzistuese që synojnë të ndihmojnë financiarisht viktimat dhe objektivat e SLAPP-ve.

53. *Mbështetje psikologjike* – Objektivat dhe viktimat e SLAPP-ve mund të kenë qasje në lloje të ndryshme të mbështetjes psikologjike konfidenciale dhe profesionale, si këshilla të drejtpërdrejta, referim tek autoritetet përkatëse shëndetësore ose ndihmë financiare për të siguruar mbështetje të pavarur dhe të drejtpërdrejtë. Shtetet Anëtare duhet të inkurajojnë autoritetet e shëndetit publik që t'i kushtojnë vëmendjen e duhur dhe t'u sigurojnë burime për shërbime të shënjestruarve dhe viktimave të SLAPP-ve.

54. *Mbështetje praktike* – Në rastet kur rrezikohet siguria e tyre fizike, të shënjestruarit dhe viktimat e SLAPP-ve duhet të kenë qasje në mekanizmat e paralajmërimit të hershëm, siç janë linjat telefonike të operuara nga organizatat e shoqërisë civile ose agjencitë e pavarura shtetërore. Në situata të jashtëzakonshme, Shtetet Anëtare duhet të kenë mekanizma efektivë dhe specifikë gjinorë për evakuimin vullnetar në një vend të sigurt dhe mbrojtjen policore. Aty ku është e mundur, mekanizmat dhe instrumentet ekzistuese kombëtare që janë në dispozicion për llojet e tjera të të shënjestruarve dhe viktimave duhet të vihen në dispozicion edhe për objektivat e SLAPP-ve.

55. *Mbështetje e sektorit privat* – Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që akterët përkatës të sektorit privat të respektojnë të gjitha ligjet e zbatueshme që synojnë mbrojtjen e të shënjestruarve dhe viktimave të SLAPP-ve, dhe të ofrojnë mbështetje sipas nevojës. Një mbështetje e tillë duhet të shtrihet si për punonjësit ashtu edhe për bashkëpunëtorët e angazhuar në një kapacitet të pavarur.

56. *Mbështetje informative* – Shtetet Anëtare duhet të inkurajohen të mbledhin në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme, dhe të shpërndajnë informacion të lirë dhe lehtësisht të qasshëm në lidhje me organizatat vendore dhe ndërkombëtare që ofrojnë lloje të ndryshme të mbështetjes për të shënjestruarit dhe viktimat e SLAPP-ve.

IV. Edukimi, trajnimi dhe ndërgjegjësimi

57. Shtetet Anëtare duhet të inkurajojnë organet përkatëse që t'i japin rëndësi këtij rekomandimi – dhe materialeve edukative që kanë të bëjnë me çështjet që ai trajton, duke përfshirë çështjet specifike gjinore – në programet arsimore dhe ato të trajnimit. Programe të tilla duhet të përfshijnë trajnime të përshtatura për gjyqësorin, profesionistët ligjorë dhe autoritetet publike përkatëse, duke marrë parasysh praktikën gjyqësore të vendosur të Gjykatës, mjetet ekzistuese procedurale, standardet dhe vlerat thelbësore dhe rregullat deontologjike të profesionit.

58. Shtetet Anëtare duhet të inkurajojnë, duke respektuar lirinë editoriale të gazetarëve dhe mediave, aktivitete ndërgjegjësuese në dobi të gazetarëve, akterëve të tjerë të medias dhe vëzhguesve të tjerë publikë për çështjet e trajtuara në këtë rekomandim. Aktivitete të tilla duhet të theksojnë rëndësinë e veprimit në përputhje me etikën gazetareske, ligjore apo etikë tjetër profesionale si mburoja e parë kundër SLAPP-ve. Aktivitete të tilla duhet gjithashtu të lehtësojnë qasjen në burime dhe mekanizma, ndërkombëtarë, rajonalë, kombëtarë dhe lokalë, për mbrojtjen e të gjithë akterëve kur ata janë në shënjestër të SLAPP-ve.

59. Shtetet Anëtare duhet të zhvillojnë ose të lehtësojnë zhvillimin e strategjive dhe masave më të gjera për rritjen e ndërgjegjësimin, siç janë fushatat që synojnë publikun e gjerë që fokusohen në vlerën demokratike dhe shoqërore të pjesëmarrjes së publikut dhe rreziqet e SLAPP-ve dhe efektet e tyre të dëmshme.

V. Koordinimi kombëtar dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

60. Shtetet Anëtare duhet të promovojnë qëllimet e këtij rekomandimi në nivel kombëtar, përfshirë gjuhët kombëtare, rajonale dhe të pakicave të vendit, dhe të angazhohen dhe të bashkëpunojnë me të gjitha palët e interesuara për të arritur shpërndarjen sa më të gjerë të përmbajtjes së tij në një sërë materiale publicitare.

61. Shtetet Anëtare duhet të bashkërendojnë aktivitetet e tyre zbatuese, duke përfshirë përmes pikave qendrore kombëtare ekzistuese ose të krijuara me qëllim, në një mënyrë konstruktive dhe gjithëpërfshirëse me autoritetet kombëtare kompetente dhe një gamë të gjerë akterësh, përfshirë të shënjestruarit dhe viktimat e SLAPP-ve.

62. Për të arritur qëllimet e këtij rekomandimi dhe me synimin për të vazhduar kontributin në zhvillimin e standardeve dhe mekanizmave përkatës plotësues kundër SLAPP-ve, Shtetet Anëtare duhet të rrisin bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, ekspertizës dhe praktikave më të mira me shtetet e tjera dhe në forumet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare.

Ky përkthim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Këshillit të Evropës dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Bashkimi Evropian është një bashkim ekonomik dhe politik i 27 vendeve evropiane. Ai bazohet në vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai vepron globalisht për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërive, mjedisit dhe ekonomive, në mënyrë që të gjithë të mund të përfitojnë.

www.europa.eu

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Përkthimi është bashkëfinancuar
nga Bashkimi Evropian



COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE